

GJENDJA E SELEFIT NË MUAJIN E RAMAZANIT



Gjendja e Selefit në muajin e Ramazanit

Përktheu: Abdul-Melik - Besfort Maxhuni

Korrektura: Dren Boshnjaku

Recenzoi: Xhemal Jakupi

Falënderimet dhe lavdërimet i takojnë vetëm Allahut, të Madhit dhe Fuqiplotit, i Cili e bekoj [dalloi] muajin e Ramazanit nga muajt tjerë si dhe paqja e mëshira e Allahut qoftë mbi të Dërguarin e Tij Muhammedin alejhis selam, familjen e tij, shokët e tij si dhe mbi të gjithë ata që e pasojnë rrugën e tij deri në Ditën e Shkatërrimit.

Thotë Allahu, në Kur'anin e Tij fisnik: **“Muaji i Ramazanit që në të (filloi) të shpallet Kur'ani, që është udhëzim për njerëzimin dhe dallues (i së vërtetës nga e pavërteta).”** (Sure el-Bekare, ajeti i 185-të).

Vëlla dhe motër muslimane, dije se Allahu aze ve xhel-le ka veçuar muajin e Ramazanit nga muajt tjerë me shumë veçori dhe begati, siç janë këto:

1. era e gojës së agjëruesit është më e mirë për Allahun sesa era e miskut (lloj parfumi)
2. engjëjt (melaiket) e Allahut kërkojnë faljen e mëkateve për agjëruesit, derisa ta hanë iftarin

3. Allahu e zbukuron dhe e stolisë Xhennetin në këtë muaj për çdo ditë
4. burgosen djajtë (shejtanët)
5. hapen dyert e Xhennetit dhe mbyllen dyert e Xhehennemit
6. në këtë muaj është një natë (nata e Kadrit), e cila është më e vlefshme se një mijë muaj dhe kujt i është ndaluar e mira e kësaj nate vetëm se i janë ndaluar atij të gjitha të mirat
7. iu falen mëkatet agjëruesve në natën e fundit të këtij muaji të bekuar dhe
8. Allahu me mëshirën e Tij i liron robërit e Tij nga Xhehennemi dhe i futë ata në xhennet.

Kështu, vëlla dhe motër muslimane këto janë disa nga mirësitë e këtij muaji dhe ki kujdes që të mos pakësosh diç nga këto mirësi, me preokupime të kota, si tubimet e padobishme, kalimi i netëve të këtij muaji në gjëra të kota apo të ndjesh pakënaqësi për

ardhjen e këtij muaji të bekuar; i kërkojmë Allahut mbrojtje nga të gjitha këto cilësi.

Robi i mirë e mirëpret këtë muaj me pendim të sinqertë dhe qëndrim serioz për shrytëzimin e këtij muaji në të mira, duke shfrytëzuar kohën e tij vazhdimisht me punë të lavdëruara, dhe duke kërkuar gjithnjë nga Allahu që ta ndihmojë për adhurim të mirë.

Vëlla dhe motër muslimane, po i cekim disa nga punët e mira me shpresë se do t'i kemi parasysh këto në këtë muaj e të punojmë me to.

Përmbajtja

1.	Agjërimi	8
2.	Namazi i natës (teravitë).....	10
3.	Lëmosha	13
4.	Leximi i Kur'anit.....	18
5.	Qëndrimi në xhami deri në lindjen e diellit....	22
6.	I'tikafi*	24
7.	Umreja	26
8.	Nata e Kadrit	27
9.	Lutja e Allahut dhe kërkimi i faljes nga Ai	30

1. Agjërimi

Thotë Muhammedi alejhis selam: “Çdo punë e mirë e birit të Ademit shpërblehet dhjetë deri shtatëqind fish.” Allahu thotë: “Përveç agjërimit, ai është për Mua, dhe Unë shpërblej për të, ngase ai ka braktisur kënaqësitë, ushqimin dhe pijen e tij për Mua. Dhe për agjëruesin ka dy gëzime; Gëzimi i tij kur ta hajë iftarin dhe gëzimi i tij kur të takohet me Zotin e tij. Dhe, era e gojës së agjëruesit është më e mirë tek Allahu sesa era e miskut (lloj parfumi).” (Transmeton Buhari dhe Muslim).

Transmeton Buhari dhe Muslim, se i Dërguari i Allahut ka thënë: “Kush agjëron me bindje të plotë duke llogaritur (në shpërblimin e Tij) i falen të gjitha mëkatet e bëra më parë.”

Padyshim se këto shpërblime të mira nuk janë vetëm për atë se ai e lenë ushqimin dhe pijen, ngase Muhammedi alejhis selam ka thënë: “Kush nuk i braktisë fjalët e ndyta dhe punët e kota, Allahu nuk

ka nevojë që ai ta braktisë ushqimin dhe pijen.”
(Transmeton Buhari)

Muhammedi alejhis selam ka thënë gjithashtu:
“Agjërimi është mburojë dhe kur është ditë agjërimi,
nuk bën të fliten fjalë të ndyta dhe të bëhen punë të
këqija, e nëse e ngacmon (agjëruesin) ndokush le të
thotë se jam agjërues.”

2. Namazi i natës (teravitë)

Thotë Muhammedi alejhis selam: “Kush ngritet për të falur namaz (të natës) në Ramazan me besim të plotë, duke llogaritur në shpëblimin e tij, do t’i falen mëkatet e bëra më parë.” (Transmeton Buhariu dhe Muslimi)

Allahu i Lartmadhëruar thotë: “Dhe robërit e të Mëshirshmit (Allahut) janë ata të cilët ecin në tokë me përulje (jo kryelartë) dhe në qetësi, dhe kur u drejtohen atyre të pa diturit (me fjalë të këqia), ata ua kthejnë me fjalë të buta e mirësi (paqë). Dhe ata të cilët e kalojnë natën para Zotit me fytyrë në tokë, në sexhde dhe në këmbë (në adhurim të Tij).” (Sure Furkan, ajeti i 63-të dhe i 64-ët).

Namazi i natës ka qenë traditë (adet) e vazhdueshme e Pejgamberit alejhis selam dhe e shokëve të tij. Aishja (Zoti qoftë i kënaqur me të) thotë: “Mos e le namazin e natës, se me të vërtetë i Dërguari i Allahut nuk e ka lënë atë kurrë, e kur ka qenë i sëmurë apo kur nuk ka mundur është falur ulur.”

Ka qenë Umeri radijallahu anhu, i cili falte namaz të natës aq sa dëshironte Allahu, e kur hynte gjysma e natës e zgjonte familjen për t' u falur, duke iu drejtuar atyre me këto fjalë: "Namazi, namazi!" dhe citonte ajetin: "Urdhëroje familjen të falë namaz, dhe ji i qetë e durimtar me ta. Ne nuk kërkojmë nga ti furnizim, Ne të furnizojmë ty dhe fundi i mirë është për të devotshmit." (Sure TaHa, ajeti i 132-të).

Ka qenë i biri i Umerit, Abdullahu, i cili shpesh citonte ajetin: "(A mosbesimtari e ka gjendjen më të mirë) Apo ai që i është nënshtruar Allahut, duke bërë sexhde dhe duke qëndruar në namaz gjatë orëve të natës, duke pasur frikë jetën e Pastajme dhe duke shpresuar në mëshirën e Zotit të tij." (Sure ez-Zumer, ajeti i 9-të), duke thënë se ky është Uthman Ibn Affani (kënaqësia e Allahut qoftë mbi të), e thotë Ibn Hatimi: "E ka thënë këtë biri i Umerit, duke patur për qëllim namazin e shumtë të Uthmanit që e falte natën dhe leximin e tij të shumtë në këtë namaz, ndoshta lexonte tërë Kur'anin në një rekat."

Thotë Alkame Ibn Kajsi: “Isha një natë musafir i Abdullah Ibn Mesudit radijallahu anhu, dhe ai u ngrit në fillim të natës që të falej. Ai filloi leximin e Kur’anit ashtu sikurse lexonte imami në xhami (me zë të bukur), dhe të gjithë ne u fascinuam nga bukuria e zërit që kishte, dhe vazhdoi kështu deri sa mbeti edhe pak kohë për ezanin e sabahut, pastaj e përfundoi dhe fali namazin e vitrit.”

Thotë Saib Jeziti: “Kanë qenë lexuesit e namazit të natës, të cilët lexonin me qindra ajete (nga Kur’ani), derisa ne mbështeteshim mbi shkopinj (nga lodhja), për shkak të gjatësisë së namazit të tyre.”

Dije, vëlla i dashur se është mirë që ta plotësosh namazin e taravive me imam, ngase thotë Muhammedi alejhis selam: “Kush falet bashkë me imamin deri sa ta përfundojë ai (imami) i shkruhet atij sikur të ketë falur namaz të natës.” (Transmeton Ahmed, Ebu Davud, Tirmidhi, Nesai dhe Ibn Maxheh)

3. Lëmosha

Muhammedi alejhis selam ka qenë shumë dorëlibër për lëmoshë dhe bamirës ndaj njerzëve, mirëpo bujaria dhe bamirësia e tij më së shumti shtoej në muajin e Ramazanit. Muhammedi (paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të) ka thënë: "Lëmosha (sadakaja) më vlefshme është ajo që jepet në muajin e Ramazanit." (Transmeton Tirmidhi)

Zejd Ibn Eslemi transmeton, se babai i tij ka thënë: "Kam dëgjuar Umerin radijallahu anhu duke thënë: 'Na urdhëroi i Dërguari i Allahut që të japim lëmoshën (sadakanë)!'" Thotë Umeri: "Ishte ky urdhër në favor timin, sepse kisha pasuri dhe thashë: 'Në qoftë se edhe sot nuk ia kaloj Ebu Bekrit, kurrë më nuk do t'ia kaloj. Dhe shkova tek i Dërguari i Allahut me gjysmën e pasurisë, e ai më pyeti se çka i kam lënë familjes time. Unë u përgjegja: gjysmën e saj. Pastaj erdhi Ebu Bekri (Zoti qoftë i kënaqur me të) me tërë pasurinë. E pyeti Muhammedi alejhis selam se çka i ka lënë familjes së tij, ai u përgjigj duke thënë: 'Allahun dhe të Dërguarin e Tij.' Atëherë, unë

thashë: ‘Kuptova se nuk mund dot t’ia tejkaloj Ebu Bekrit në bamirësi.’”

Shpresoj, motër dhe vëlla musliman, se e keni kuptuar sado pak vlerën e lëmoshës (sadakasë), sidomos në këtë muaj, pra, mundohuni të arrini këtë begati, aq sa keni mundësi. Ja disa nga mënyrat që jua lehtësojnë t’i arrini këto mirësi.

a) Të ushqyerit apo dhënia e ushqimit - Thotë Allahu në Kur’an: “Dhe ata që u japin ushqim të varfërve, jetimëve dhe të zënëve robër (duke thënë): ‘Ne po i ushqejmë vetëm për fytyrën e Allahut, ne nuk duam prej jush as shpërblim e as falënderim.’” (Sure el-Insan, ajeti i 8-të dhe i 10-të).

Selefi (nga sahabët dhe tabi’inët) kanë qenë prijës dhe shëmbëlltyrë e pashoqe në të ushqyerit e njerzëve, pa marrë parasysh se kush ishte ai, duke mos dalluar të mirin nga i keqi dhe nuk përqëndroheshin vetëm në të varfërit.

Thotë Muhammedi alejhis selam: “O ju njerëz, përhapeni selamin (përshëndetjen), jepni ushqim,

mbani marëdhëniet farefisnore, faleni namazin e natës kur janë njerëzit në gjumë, që të hyni në Xhennet me selam (paqë).” (Transmeton Ahmed dhe Tirmidhi, dhe thotë Albani se hadithi është i vërtetë (sahih)).

Kanë thënë disa nga Selefii: “Që t’i ushqej dhjetë vetë nga shokët e mi, është më e dashur për mua sesa t’i liroj dhjetë robër nga bijtë e Ismailit.”

Kanë qenë shumica nga Selefii, të cilët ndikonin tek njerëzit me iftarin e tyre kur ishin të agjërueshëm, prej tyre: Abdullah Ibn Umeri radijallahu anhu, Davud et-Tai, Malik Ibn Dinari, Ahmed Ibn Hambeli, ka qenë Ibn Umeri, i cili çdoherë u jepte iftar jetimëve, bonjakëve dhe të varfërve, edhe pse e ka ditur se familja e tij e mohojnë një gjë të tillë nga ai.

Ka pasur raste, gjithashtu prej Selefii, kur njeriu i ushqente njerëzit duke qenë agjërueshëm, dhe duke i shërbyer e gostitur ata, siç ishte Hasen el-Basri dhe Abdullah Ibn Mubareku.

Thotë Ebu Surar el-Adevij: “Ka pasur njerëz nga fisi Beni Adij, që faleshin në xhami dhe asnjëri prej tyre nuk bënte iftar i vetmuar, nëqoftëse gjenin dikë për t’iu bashkangjitur në iftar hanin me të, (e në qoftëse nuk gjenin) ata nxirrnin ushqimet e tyre në xhami, duke ngrënë së bashku me njerëzit tjerë.”

Dhe ky lloj adhurimi (ibadeti), d.m.th. dhënia e ushqimit, sjell edhe disa dobi dhe ibadete tjera, siç janë: Vëllazërimi dhe dashuria mes besimtarëve që ushqehen, e kjo është një nga shkaqet për hyrjen në Xhennet. Muhammedi alejhis selam thotë: “Nuk do të hyni në Xhennet derisa të besoni, dhe nuk do të besoni derisa të duheni ndërmjet vete...”, kështu që nga kjo rrjedh ibadeti, tubimi me njerëz të devotshëm dhe të shpresuarit e shpërblimit nga Allahu, duke i nxitur edhe ata në adhurime të tjera, si shkak i të ushqyerit të tyre.

b) Dhënia e iftareve - Thotë Muhammedi alejhis selam: “Kush jep iftar për agjëruesin, e ka shpërblimin sikur të agjëruesit, duke mos iu

pakësuar fare shpërblimi agjëruesit.” (Transmeton Ahmed dhe Nesai dhe e ka vërtetuar Albani).

Transmeton Selmani radijallahu anhu, se Muhammedi alejhis selam ka thënë: “Kush jep iftar për agjëruesit, ka falje mëkatesh dhe shpëtim nga zjarri (i Xhehennemit) dhe ka shpërblim të njëjtë si agjëruesi, duke mos iu pakësuar aspak (agjëruesit) nga shpërblimi i tij.”

4. Leximi i Kur'anit

Në këtë pikë do të përmendim dy nga cilësitë e Selefët:

a) Leximin e shumtë të Kur'anit dhe të qarët gjatë leximit të tij. Ishte engjëlli (meleku) Xhibril, i cili ia mësonte Muhammedit alejhis selam Kur'anin në Ramazan dhe ka qenë Uthmani radijallahu anhu, i cili përfundonte leximin e plotë të Kur'anit për çdo ditë, disa të tjerë në namazin e natës për çdo natë, dikush çdo të shtatën, e disa çdo të dhjetën, duke lexuar Kur'an në namaz dhe jashtë namazit.

Ka qenë Imam Shafiu rahimehullah, i cili lexonte Kur'anin në Ramazan gjashtëdhjetë herë, duke lexuar edhe jashtë namazeve, pastaj Katade që e përfundonte leximin e plotë çdo të shtatën ditë, kurse në Ramazan çdo të tretën, e në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit për çdo natë.

Imam Zuhriu (Allahu e mëshiroftë) braktiste çdo lloj tubimi shkencor në Ramazan, duke u përqëndruar vetëm në leximin e Kur'anit, po ashtu edhe Sufjan Theuriu linte çdo lloj adhurimi vullnetar për të lexuar vetëm Kur'an.

Ibn Rexhebi thotë: "Është ardhur ndalesa e të lexuarit të Kur'anit brenda tre ditëve, jashtë këtij muaji, kuptohet, mirëpo përsa i përket kohëve të vlefshme, si muaji i Ramazanit dhe vendeve të vlefshme, si Meka dhe Medine, për atë që është banor i këtyre dy vendeve lejohet dhe ka shpërblim ta lexojë Kur'anin (për shkak se) shfrytëzon vlerën e kohës dhe vendit." Kështu ka thënë edhe Imam Ahmedi dhe Is'haku e shumë të tjerë nga dijetarët e Selefët.

b) Të qarët gjatë leximit të Kur'anit - Nuk është nga udhëzimi i Selefët të lexuarit e Kur'anit me lexim të rëndomtë, duke mos kuptuar dhe menduar në përmbajtjen e tij, por kanë qenë ata (Selefi) në zemrat e të cilëve ndikonte Kur'ani. Transmeton Buhari nga Ibn Mesudi radijallahu anhu, i cili thotë: "Më tha i Dërguari i Allahut alejhis selam (paqja dhe mëshira

e Zotit qoftë mbi të): ‘Ma lexo Kur’anin!’ I thashë atij: ‘Si ta lexojë Kur’anin ty, përderisa të është zbritur (shpallur) ty!’ Tha: ‘Kam dëshirë që ta dëgjoj nga tjetërkush.’ Thotë Ibn Mesudi: ‘Fillova leximin e Kur’anit derisa arrita në kaptinën en-Nisa në vargun e 40-të (ajetin): ‘E si do të jetë atëherë, kur ne do të sjellim ty (o Muhamed) si dëshmitar mbi këta të gjithë.’ Më tha: ‘Mjaft!’ Tha (Ibn Mesudi): ‘Kur u ktheva kah ai, pashë se i rridhnin lotët.’”

Transmeton Bejhekiu nga Ebu Hurejra radijallahu anhu i cili thotë: “Kur zbritën ajetet: ‘A habiteni nga ky rrëfim (Kur’ani)! E po qeshni e nuk po qani. Madje edhe e zëni në asgjë.” (Sure en-Nexhm, ajeti 59-të dhe i 61-të). Qajtën të gjithë banorët e Sufës (këta nuk kishin shtëpi dhe familje, dhe banonin në xhaminë e Pejgamberit alejhis salam), duke iu rrjedhur lotët nëpër faqet e tyre (nga frika që kishin prej Allahut), e kur dëgjoi për këtë Pejgamberi alejhis salam qau edhe ai me ta, me ç’rast qajtën edhe të tjerët derisa Muhammedi alejhis salam tha: “Nuk i kaplon zjarri i xhehennemit ata të cilët qajnë nga frika prej Allahut.”

Umeri, kënaqësia e Allahut qoftë mbi të, kur arriti në vargun (ajetin) e 6-të të kaptinës (sures) Mutafi-fifin: “Atë ditë njerëzimi do të qëndrojë para Zotit të botrave” aq shumë qau, sa që e humbi vetëdijen nga frika e madhe që kishte, duke mos mundur ta përfundojë leximin e tij.

Muzahin Ibn Zefiri thotë: “Ne e falnim namazin e mbrëmjes (akshamit) me Thevriun, dhe me të arritur në ajetin e 5-të të sures el-Fatiha: ‘.... vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë dhe ndjesë kërkojmë,’ qau aq tepër sa që iu ndërpre leximi, dhe më pas filloi leximin nga fillimi i kaptinës (sures).

5. Qëndrimi në xhami deri në lindjen e diellit

Muhammedi alejhis selam pasi falte namazin e mëngjesit (sabahut) qëndronte në faltoren e tij (duke përmendur Allahun) derisa lindte dielli. (Transmeton Muslimi)

Transmeton Tirmidhi nga Enesi, se i Dërguari alejhis selam ka thënë: “Kush e fal namazin e mëngjesit (sabahut) me xhemat e pastaj qëndron në xhami, duke e përmendur Allahun derisa në lindjen e diellit e më pas ngrihet dhe fal namaz dy rekatësh, e ka shpërblimin e haxhit dhe umres së plotë, së plotë, së plotë.” (Albani thotë se hadithi është i vërtetë (sahih)).

I gjithë ky shpërblim në ditët e rëndomta. A thua si qëndron çështja e ditëve të Ramazanit?!

Kështu, vëlla dhe motër muslimane, Allahu ju ruajtë, kërkonin ndihmë nga Ai që të arrini këto shpërblime dhe grada të larta, duke u munduar që t'i pasoni gjurmët e këtyre njerzëve të mirë, me qëllim që të arrini grada të larta në Xhennet.

6. I'tikafi*

Muhammedi alejhis selam bënte I'tikaf në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit, kurse në vitin që vdiq ka bërë I'tikaf në njëzet ditët e fundit. (Transmeton Buhari dhe Muslim)

I'tikafi është një lloj adhurimi, i cili pëmbledh në vete shumë nga punët e dobishme, siç janë: leximi i Kur'anit, namazet (të obliguara dhe vullnetare), përmendjen e Allahut (dhikri), të luturit Atë për mëshirë, etj.

Ndofta dikush mund të thotë se ky lloj adhurimi (ibadeti) është i vështirë dhe kërkon mund, mirëpo kjo qëndron vetëm për ata që nuk e kanë provuar, e që është e lehtë për atë që Allahu ia lehtëson këtë adhurim. Kush vendos që ta zbatojë këtë me qëllim (nijet) të pastër dhe të sinqertë si dhe me bindje, padyschim se Allahu do ta ndihmojë në këtë.

Pra, ai cili bënë I'tikaf vetëm se e ka përqëndruar veten e tij në adhurimin e Zotit dhe përmendjen e Tij, duke ndaluar dhe larguar veten nga çdo gjë që e

pengon nga adhurimi, duke e orientuar zemrën në çdo gjë që ofron tek Ai dhe që shkakton kënaqësinë e Tij.

-* I'tikafi është adhurimi që realizohet në xhami, duke qenë i mbyllur gjatë dhjetë ditëve të muajit të Ramazanit, me qëllim të adhurimit ndaj Allahut.

7. Umreja

Janë transmetuar shumë hadithe të vërteta rreth vlerës së këtij riti fetar, në mesin e të cilave është edhe ky, ku thotë Muhammedi alejhis selam: “Umreja në Ramazan e ka shpërblimin e haxhit.” (Transmeton Buhari dhe Muslim) Në një transmetim tjetër thuhet: “Sa shpërblimi i haxhit me mua.” Allahu Ekber! Le të gëzohet ai, të cilit i mundësohet kryerja e këtij lloji të adhurimit në Ramazan me këtë shpërblim dhe dhunti kaq të madhe.

8. Nata e Kadrit

Thotë Allahu i Lartëmadhëruar: **“Vërtet, Ne e kemi zbritur (Kur’anin) natën e Kadrit. Nata e Kadrit është më e vlefshme se një mijë muaj.”** (Sure el-Kadr, ajetet e 1,2,3).

I Dërguari i Allahut alejhis selam thotë: “Kush ngrihet për t’u falur natën e Kadrit me besim dhe bindje, duke llogaritur në shpërblimin e Allahut, do t’i falen mëkatet e bëra më parë.” (Transmeton Buhari dhe Muslim)

Muhammedi alejhis selam e kërkonte natën e Kadrit, duke urdhëruar edhe shokët e tij për një gjë të tillë dhe zgjonte familjen e tij në dhjetë netët e fundit, duke shpresuar në arritjen e shpërblimit të kësaj nate të bekuar.

Transmetohet se disa sahabë (shokë të të Dërguarit të Allahut) dhe tabi’inë (gjenerata pas sahabëve) pastroheshin dhe parfumoheshin dhjetë netët e fundit, duke shpresuar në arritjen e kësaj nate të bekuar, që Allahu i Lartëmadhëruar e ka veçuar nga

netët e tjera të rëndomta, duke ngritur vlerën e saj me shumë bekime.

O ju që ju ka shkuar jeta në kotësi, mundohuni që këtë herë të mos ju ikë kjo natë e bekuar, sikurse ato të kaluarat, dhe dijeni se një punë e mirë në këtë muaj është më e vlefshme sesa një mijë të muajve tjerë, e kujt i ndalohet e mira dhe shpërblimi i saj le ta di se veç i janë ndaluar të gjitha të mirat e tjera.

Dhe ajo, Nata e Kadrit, padyshim se është në dhjetë netët e fundit të Ramazanit dhe ajo është në netët tek, e sidomos në natën e njëzet e shtatë, ashtu si e ka transmetuar Muslimi nga Ubej Ibn K'abi se ka thënë: "Për Zotin, unë e di se cila natë është ajo; është nata në të cilën i Dërguari i Allahut, Muhammedi alejhis selam na urdhëronte që të faleshim, e kjo ishte nata e njëzet e shtatë."

Ka pyetur Aishja, kënaqësia e Allahut qoftë mbi të, të Dërguarin e Allahut alejhis selam duke i thënë: "O i

Dërguar i Allahut, nëse e qëllon Natën e Kadrit, ç'të lutem?" Tha: "O Zoti im, vërtet Ti je falës dhe e do faljen, më fal mua." (Transmeton Ahmed dhe Tirmidhiu dhe e ka vërtetuar Albani).

9. Lutja e Allahut dhe kërkimi i faljes nga Ai

Le të jetë kërkimi i faljes nga Allahu më shumë i theksuar në netët e muajit të Ramazanit, në ditët dhe netët që janë më të vlefshme se çdo kohë tjetër, atëherë shfrytëzoje këtë kohë duke e përmendur Allahun, sidomos në kohën kur nuk refuzohet lutja, siç janë:

- Para ngrënies së iftarit, d.m.th. lutja e agjëruesit (në kohën kur afrohet koha e ngrënies, me rastin e pritjes së ezanit të mbrëmjes) nuk refuzohet;
- Pjesa e tretë e natës, në të cilën kohë Allahu zbret në qiellin e kësaj bote, duke thënë: “A ka dikush që kërkon diç nga Unë, që t’ia plotësoj (dëshirën); Dhe ndokush që kërkon falje mëkatesh, e që Unë t’ia fali.”
- Kërkimi i faljes (istigfari në syfyr). Thotë Allahu xhel-le ve ala: “... **dhe në orët e para të agimit kërkojnë falje.**” (Sure edh-Dharijat, ajeti i 18-të).

Dhe në fund, vëlla dhe motër muslimane, pas të gjitha këtyre këshillave të arta, të këshilloj edhe me diçka shumë të rëndësishme. A e di se ç'është kjo? Është sinqeriteti (ihlasi) në vepër, e sa gjë e mirë është sinqeriteti!

Sa e sa nga agjëruesit janë që nga agjërimet e tyre nuk fitojnë gjë veçse uri dhe etje, e sa e sa nga falësit e namazit në këtë muaj nuk përfitojnë gjë nga namazi i tyre veçse lodhje dhe mundim, e sa e sa... Allahu na ruajtë nga këto.

Për këtë shohim se Muhammedi alejhis selam në disa hadithe ka thënë: "... me besim dhe llogaritje..."

Kanë qenë Selefët (gjeneratat e para nga sahabët, tabi'inët dhe pasuesit më të mirë pas tyre) të cilët kanë fshehur punët e tyre të mira nga njerëzit, duke pasur frikë nga hyrja e shikimeve (sye-faqësisë) në zemrat e tyre dhe kështu t'iu shkatërrohen veprat.

Dhe ja, ky është Ej-jub Sahtijani, që për të tregon Hammad Ibn Zejdi duke thënë: “Ishte Ej-jubi Sahtijani, që kur citonte ndonjë hadith qante, dhe për ta fshehur të qajturit e tij nga njerëzit, ai kollitej dhe fërkonte sytë me duar kinse është sëmurë dhe thoshte se sa sëmundje e fortë më paska goditur.”

Thotë Muhamed Ibn Vasië: “Kam arritur njerëz që më kanë treguar se ka pasur njeri që ka fjetur me bashkëshortën e tij në një jastëk, e (njeriut) i kanë rrjedhur lotët nëpër faqe (duke kujtuar mëkatet) duke mos e vërejtur këtë bashkëshortja e tij. Gjithashtu më kanë treguar se derisa njeriu ka qenë duke falur namaz, nga frika që kishte prej Zotit i rridhnin lotët nëpër faqe, duke mos e vërejtur këtë ai që ishte pranë tij.”

Ej-jub Sahtijani, Zoti e mëshiroftë, falte tërë natën namaz, duke mos e ditur askush nga familja e tij, e pak para se të afrohej koha e namazit të mëngjesit (sabahut) ngriste zërin kinse është ngritur në atë kohë.

Thotë Ibn Ebu Adij: “Ka agjëruar Daud Ibn Hindi dyzet vjet (agjërim vullnetar), duke mos e ditur këtë familja e tij. A dini se ç'bënte ky njeri? Merrte ushqimin e drekës që i ofrohej atij dhe ua shpërndante të varfërve nëpër rrugë, pastaj kthehej natën tek familja e tij dhe hante së bashku me ta ushqimin e darkës.”

Sufjan Theuriu thotë: “Vërtet robi punon në fshehtësi deri sa djalli (shejtani) mundohet vazhdimisht ta nxisë atë që ta publikojë punën që e ka bërë, pastaj vazhdon djalli me këtë nxitje e cytje derisa t'ia futë në zemrën e tij dashurinë ndaj asaj që njerëzit ta lavdërojnë atë, e kur i mallkuari e arrin këtë, prej këtij momenti vepra shndërrohet nga singeriteti në sy-e-faqësi dhe kështu humb shpërblimi.”

Vëlla dhe motër muslimane, ndoshta e teprova duke ua humbur kohën me këtë.... unë ju këshillova për shfrytëzimin e saj, mirëpo kërkoj falje dhe mirëkuptim nga ju, që edhe këtë herë të duroni pak që së bashku ta kuptojmë këtë realitet të hidhur; Ky është realiteti i dukshëm i humbjes së kohës së tepërt

në gjëra që nuk kanë dobi dhe që nuk ofrojnë respektimin e Allahut, dhe është largim nga mëshira e Allahut dhe kënaqësia e Tij. Thotë Allahu i Lartmadhëruar: **“Dhe kushdo që ia kthen shpinën përkuajtimit Tim, padyshim që për këtë do të ketë jetë të vështirë dhe në Ditën e Ringjalljes Ne do ta ringjallim të verbër, e ai do të thotë: ‘O Zoti im! Përse më ke ringjallur të verbër, kur unë isha me sy?’ Allahu do t’i thotë: “Ashtu si harrove ti argumentet Tona që t’i ofruam, ashtu je ti i harruar sot”. Dhe në këtë mënyrë Ne e shpërblejmë atë që kalon kufijtë (duke mos besuar Allahun, të Dërguarin e Tij dhe Kur’anin) dhe nuk beson në argumentet e Zotit të tij, dhe ndëshkimi i jetës së pastajme është shumë i ashpër dhe i vazhdueshëm.’ A nuk shërben si udhëzim për ta (që të dinë) se sa shumë breza Ne kemi shkatërruar para tyre nëpër vendbanimet e të cilëve ecin. Me të vërtetë që këtu ka shenja të qarta për njerëzit me arsye të shëndoshë.”** (Sure TaHa, ajetet e 124 deri 127-të).

Të pyes, për Zotin, më trego si nuk ndien dhembje në veten tënde për atë çka po sheh nga punët e shumicës së të rinjve muslimanë, të cilëve u është mbushur dhe kapluar zemra me preokupime boshe, e sidomos kur vërejmë në netët e këtij muaji të bekuar shkelje të ndalesave dhe bërje të mëkateve ndaj Zotit.

Mirëpo... mos u mërzit. Vëlla e motër... vërtet, rruga për lumturinë tënde dhe vëllezërve e motrave tua është të thirrurit ata në rrugën e Allahut dhe të luturit për udhëzimin e tyre. Po, është thirrja drejtuar vëllezërve dhe motrave të preokupuara me rrugën e lajthitur, ndoshta një ditë do t'i përgjigjen thirrjes, kur Allahu të dëshirojë, e shpresën mos e humbni.